

Oliverta Lila - Shqip

Ardian Ahmedaja: Regjistrimet e rralla që kam gjetur në Arkivin e Berlinit

Sillet në Tiranë edhe një CD me regjistrime të rralla shqiptare. Është realizuar nga studiuesi shqiptar, Ardian Ahmedaja (i cili punon në Institutin e Muzikës në Vjenë) me materiale të marra nga Arkivi Zanor i Berlinit. Janë regjistrime të bëra nga 1903 në Mirditë e Shkodër nga Paul Treger, regjistrime të vitit 1957 dhe të viteve '90

Studiues nga vende të ndryshme të botës kanë çelur dje në Tiranë simpoziumin e dytë ndërkombëtar të Grupit Studimor për Muzikën Shumëzërëshe (njohur në Shqipëri si polifonia). Organizuar nga fondacioni "Ulysses" në bashkëpunim me Institutin e Studimit të Muzikës Popullore dhe Etnomuzikologjisë pranë Universitetit të Muzikës dhe Arteve të Interpretimit në Vjenë dhe MTKRS, ky simpozium synon promovimin e kulturës shqiptare dhe vendosje kontaktesh për bashkëpunime të mëtejshme. Në këtë kuadër, sillet në Tiranë edhe një CD me regjistrime të rralla shqiptare. Është realizuar nga studiuesi shqiptar, Ardian Ahmedaja (i cili punon në Institutin e Muzikës në Vjenë) me materiale të marra nga Arkivi Zanor i Berlinit. Janë regjistrime të bëra nga 1903 në Mirditë e Shkodër nga Paul Treger, regjistrime të vitit 1957 dhe të viteve '90. Ahmedaja tregon se ka shumë materiale të tjera që do të donin kolona të tëra për t'u botuar, e sipas tij vëmendja e institucioneve shqiptare duhet të jetë më e madhe. Në këtë kuadër ai ka kritika edhe për ato pak aktivitete që synojnë të promovojnë muzikën tradicionale, siç janë festivalet, sepse sipas tij, po dëmtojnë bartësit e kësaj muzike dhe përcjelljen e kësaj muzike ndër vite.

Simpoziumi i dytë i Grupit Studimor për Muzikën Shumëzërëshe po zhvillohet në Shqipëri. Për çfarë të do të ndikonte ky organizim lidhur me traditën muzikore shqiptare?

Simpoziumi është përqendruar në tri tema: kreativiteti në muzikën shumëzërëshe, lidhja e muzikës lokale me atë fetare dhe çmimet që merr kjo muzikë në paraqitjet publike siç janë festivalet. Gjatë konferencës, por edhe librin që do të botohet më pas këtu, Shqipëria do të zërë një vend të veçantë si vendi organizator i këtij eventi dhe më e rëndësishme është që futet në hartën e kësaj organizate. Studimet etnomuzikologjike në Shqipëri ende nuk ndihmohen nga universiteti ku nuk ka një kurikul të etnomuzikologjisë. Ky aktivitet mund t'i japë një impuls tjetër qoftë politikës apo institucioneve përgjegjëse që të hapet një kurikul e etnomuzikologjisë në Universitetin e Arteve.

Mbi 20 studiues nga vende të ndryshme të botës do të flasin për muzikën shumëzërëshe apo siç e njohim ne, polifoninë. Sa e njohin ata fenomenin shqiptar në këtë fushë?

Praktikat muzikore shumëzërëshe në Shqipëri janë të njohura në një rreth relativisht të vogël

studiuesish jashtë shtetit, sepse nuk kanë pasur mundësi të bëjnë ekspedita dhe ta njohin këtë muzikë. Ka vetëm një ekspeditë profesioniste të organizuar në 1957 nga gjermanët në bashkëpunim me specialistët shqiptarë, por pas prishjes së marrëdhënieve politike, specialistët vinin vetëm për Festivalin e Gjirokastrës dhe ishin gjithnjë të shoqëruar. Por ata që e njohin këtë muzikë e çmojnë shumë jo vetëm nga ana muzikore, por edhe për faktin se njerëzit e këndojnë kudo, në skenë, në shtëpi, mes miqve. Ata janë të kënaqur që gjatë aktiviteteve do të dëgjojnë edhe këngëtarë shqiptarë.

Ju keni realizuar edhe një CD me incizime të hershme shqiptare. Në çfarë viti datojnë dhe ku janë regjistruar?

Janë regjistrime të nxjerra nga Arkivi Zanor i Berlinit, i formuar më 1900, i dyti pas arkivit të Vjenës(1899). Atëherë incizonin në cilindra dylli dhe në bazë të fuqisë që jep zëri një gjilpërë linte gjurmë në dyllë dhe po me këtë gjilpërë mund ta përktheje sërish në muzikë. Në Arkivin Zanor të Berlinit ka një koleksion jashtëzakonisht të madh nga e gjithë bota, i cili u çua në Rusi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Deri në 1991 u quajt i humbur, por u kthye dhe për fat të mirë nuk ishte i dëmtuar. Ata nisën një projekt dixhitalizimi të këtyre koleksioneve. Në vitin 2002 më ftuan mua të dëgjoja këto disa regjistrime të bëra në 1903 nga Paul Treger e të bëja një studim mbi to, një punë që zgjati 2 vjet. Puna u çua më tej në 2008, kur unë konkurrova në një projekt të Bashkimit Europian për realizimin e 2 CD me incizimet e këtyre arkivave. Përveç incizimeve të 1903, aty gjenden edhe regjistrimet e ekspeditës së 1957-s dhe disa të tjera të bëra nga gjermanët në vitet '90. Pikërisht në kudër të këtij aktiviteti, bashkë me fondacionin "Ulysses", vendosëm ta sjellim këtë CD edhe në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë.

A ka një historik të këtyre regjistrimeve?



*Paul Traeger 1867-1933
(Discovering Albania 2012, 9)*

Paul Treger ka qenë 30 vjet sekretar i Shoqatës për Historinë e Vjetër dhe Arkeologjisë në Berlin. Si bir i një fabrikanti të pasur, kishte mundësi të lëvizte dhe ka qenë i interesuar për Ballkanin. Nga 1899 deri më 1903 ka ardhur çdo vit në Shqipëri, i interesuar veçanërisht për arkeologjinë, por edhe për shqiptarët, duke bërë kryesisht studime të karakteristikave të këtyre njerëzve (madhësia e kokës, forma). Në 1903 ka marrë mjetet për të incizuar dhe ka bërë regjistrime në Mirditë dhe Shkodër, pasi ai besonte se atje ishin katolikët që nuk ishin prekur nga regjimi otoman dhe ishin shqiptarë të vërtetë, gjë që nga ana teorike kjo sot nuk qëndron.

Në këtë punë të tij është ndihmuar edhe nga priftërinjtë, të cilët kishin bërë një zgjedhje shumë të mirë të këngëve. Unë nuk kam gjetur

akoma një informacion të veçantë që mund të ketë dhënë për këtë vizitë në Shqipëri.

Ju keni gjetur po ashtu edhe incizime të vitit 1957. A ka materiale të tjera ende të pastuduara në Arkivin Zanor të Berlinit?



Pjesemarresit e ekspedites ne Cakran, jugu i Shqiperise

(nga e majta ne te djathte): Wilfried Fiedler, Erich Stockmann, Ramadan Sokoli, Albert Papparisto (?).

(Discovering Albania 2012, 18)

Përveç incizimeve, ka instrumente të muzikës qoftë nga 1903 qoftë nga 1957, të cilët i kanë blerë gjatë vizitës në Shqipëri. Paul Treger ka vizatuar shumë bukur sende të jetës së përditshme, instrumente, djepe, vegla pune, armë, ndërsa ka një koleksion shumë të bukur fotografish nga ekspedita e 1957-s, materiale që po të botoheshin do të bënin një kolanë më vete. Në këtë arkiv nga Treger janë 28 incizime dhe 30 orë regjistrime nga ekspedita gjermane e '57-s. Por unë jam në dijeni që materiale ka edhe në arkivat e Hungarisë, Danimarkës, Vjenës, Anglisë, te shqiptarët në Amerikë. Ne flasim për muzikën, por janë shumë të rëndësishëm edhe njerëzit që e bëjnë këtë muzikë, të cilëve nuk u krijojmë kushtet që duhen.

Mendoni se do të rrezikohet nga zhdukja kjo muzikë?

Muzika do të jetojë, sepse njerëzit nuk rrinë dot pa muzikë, por a do të jetë e njëjta edhe pas 100 vjetësh? Kjo nuk mund të thuhet me saktësi, sepse ka shumë faktorë që ndikojnë. Institucionet duhet të kthejnë vëmendjen te njerëzit që e bëjnë muzikën. Është shumë mirë që bëhen festivale, por duhet të ndryshojë konceptimi i tyre, sepse për kufizimet që u vënë pjesëmarrësve, më duken ende si në kohën e komunizmit. Të marrim si shembull edhe

Festivalin Folklorik të Gjirokastrës. Shumë grupe që përgatisin nga 6 orë material muzikor, ngjiten në skenë për të kënduar vetëm gjysmë ore. Si mund t'i lësh një lahutari vetëm 7 minuta kur një këngë me lahutë shkon deri në 1 orë e gjysmë. Është njëloj sikur të bëjmë një krahasim me një film artistik: ai zgjat një orë e gjysmë dhe 3 minuta është reklama që i bëhet. Këtë bëjmë edhe ne me muzikën tradicionale, bëjmë vetëm një reklamë të asaj që ia paraqesim publikut si muzikë. Duhet të ndryshojë mënyra e organizimit të këtyre aktiviteteve. Disa nga këngëtarët që kam takuar më pyesin: e do këngën e shkurtër?

Praktika e gabuar e skenës i ka mësuar t'i shkurtojnë gjërat edhe në përditshmëri dhe kjo humb cilësinë për të menduar në distancë të madhe kohe. Ne do të shpresojmë të bëjmë sa të jetë e mundur që këngëtarët dhe instrumentistët të mos ia lejojnë vetes që të tjerët t'i thonë dil në skenë, por ke vetëm dy minuta.

Simpoziumi

Përfaqësuesja e fondacionit "Ulysses" në Tiranë, Emi Aliçka, sqaron se ideja e këtij simpoziumi ishte nevojshmëri për jehonën e kulturës shqiptare jashtë vendit. "ICTM është një grup shumë serioz në kërkime dhe studime dhe ishte rasti më i mirë ta sillnim në Shqipëri dhe të krijojmë një platformë që të vendosnin marrëdhënie mes institucioneve dhe institucionet shqiptare të marrin pjesë në këto grupe studiuesish ndërkombëtarë. Shpresojmë që në këtë mënyrë kërkimi shkencor të riaktivizohet në Shqipëri, të ketë vazhdimësi dhe ne të mirëmbajmë kulturën tonë në mënyrën e duhur, të respektojmë bartësit në mënyrën e duhur dhe t'u japim terrenin e duhur për ta zhvilluar këtë kulturë", shprehet Aliçka.